



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/PUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. Br. Prot. Prot No. 03-03/1829/16
Dep. DPK/DPKPP
Nr. I faq. 03
Broj. stranica
Nr. pages
Datum Date 20.05.2016
PRISHTINE

DATË/A:	20.05.2016
REFERENC-Ë:	DPK- DPKPP-03-03/1723/16
PËR/ZA/TO:	z. Dejan TODOROVIQ, Drejtor i zyrës së Prokurimit – Komuna e Klllokotit
CC:	z. Sreqko SPASIQ, Kryetar i Komunës së Klllokotit
NGA/OD/FROM:	<i>për</i> Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Klllokot – faza II "

I nderuari z. Todoroviq,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin " Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Klllokot – faza II " me numër prokurimi: KLL-660-16-002-521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Klllokot – faza II " me numër prokurimi: KLL-660-16-002-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të ligjit nr. 05/1 -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 12.05.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokollit *AKK-03-03-1723/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull " **Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Klllokot – faza II** " me numër prokurimi: *KLL-660-16-002-521*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Klllokotit. Agjencia duke vepruar sipas detyrës zyrtare e ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim.

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 13.05.2016, ka paraqitur kërkesë për dokumentacion ku ka kërkuar nga Autoriteti në fjalë që ta dorëzoj në Agjenci tërë dokumentacionin për këtë procedurë të prokurimit para hapjes së tenderit. Autoriteti kontraktues me datë 16.05.2016 ka dorëzuar tërë dokumentacionin e kërkuar. Agjencia pasi ka pranuar dokumentacionin vëren se ky projekt është bashkëfinancim në mes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Komunës së Klllokotit dhe përfshinë fazën e dytë të projektit.

Agjencia gjithashtu me datë 19.05.2016 ka kërkuar dokumentacion shtesë më saktësisht paramasen dhe parallogarinë si dhe projektin ekzekutiv në Gjuhën Shqipe, mirëpo në shkresën e datës 20.05.2016 të cilën e ka pranuar AKK nga Komuna e Klllokotit theksohet se dokumentet në fjalë nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe për çka konsiderojmë se është shkelur neni 13 paragrafi 1 i ligjit nr. 05/1 -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237.

Sipas këtij neni "Autoriteti kontraktues do ti përgatisë të gjitha dosjet e tenderëve, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomik gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit që shpjen drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë minimale, të vogël dhe të mesme në gjuhën Shqipe dhe Serbe. Autoriteti kontraktues mundet që gjithashtu t'i përgatisë dokumentet në fjalë edhe në gjuhën Angleze". **Mos përkthimi i dokumenteve përbërëse të tenderit në gjuhët zyrtare në këtë rast edhe në Gjuhën Shqipe paraqet diskriminim dhe pabarazi në mesin e Operatorëve ekonomik.**

Legjislacioni në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Kosovës gjithashtu garanton se një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.

Arsyetimet e dhëna në shkresën e datës 20.05.2016 nga Zyrtari përgjegjës i prokurimit i cili thekson se Komuna e Klllokotit nuk ka mundësi t'i përkthej këto dokumente pasi që nuk ka staf profesional për përkthimin e këtyre dokumenteve nuk janë të pranueshme dhe nuk qëndrojnë.

Agjencia kundër Korrupsionit gjithashtu ka analizuar edhe njoftimin për kontratë dhe dosjen e përgatitur për këtë tender ku ka konstatuar shkeljet si në vijim:



Tek rubrika III.2.3) Kapaciteti ekonomik/financiar tek kërkesa nr.1 janë kërkuar të hyrat e përgjithshme së bashku për tri vitet e fundit (2012-2014) duhet të jenë minimum 150,000.00. Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 68.

Sipas këtij ligji për ta vërtetuar aftësinë ekonomike/financiare të Operatorëve ekonomik, Autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë dëshmi mbi qarkullimin bankar/financiar, por nëse vendosin në kërkesë të tillë atëherë detyrimisht duhet të kërkohet për tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, e që në këtë rast do duhej të kërkoreshin dëshmitë mbi qarkullimin financiar për vitin fiskal 2013,2014 dhe 2015. AKK vëren se një kërkesë e tillë është përsëritur edhe tek rubrika kapaciteti teknik/profesional kërkesa 3.

Në rubrikën kapaciteti teknik ose profesional pika 2 janë kërkuar minimum projekt menaxheri dhe 2 inxhinier për të cilët ndër të tjera është kërkuar që të kenë prej 10 vite për projekt menaxherin dhe **5 vite** përvojë pune për 2 inxhinierët të përcjella me nga **5 referenca**. Gjithashtu në kuadër të kësaj rubrike tek pika 3 është kërkuar lista e kontratave të nënshkruara dhe të realizuara gjatë tri viteve të fundit **2012 - 2014**, të kryera në lëmin e ndërtimit dhe punëve të ngjashme **minimum pesë (5)**, me institucion publike dhe private, duke ofruar dëshmi referencat ose raport e pranimeve teknike. Lidhur me këto kërkesa Agjencia gjithashtu konsideron se janë kërkesa diskriminuese dhe mund të kufizojnë konkurrencën e lirë në mes të Operatorëve ekonomik.

Autoriteti kontraktues duhet që çdo herë të kujdeset që gjatë përcaktimit të kërkesave të kualifikimit(kritereve të përzgjedhjes) të caktojë kërkesa minimale të cilat do të mundësonin konkurrencë më të madhe në mes OE-ve.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 68 Gjendja ekonomike financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të ligjit nr. 05/1 -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë kundër Korrupsionit për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !